



Pranuar / Dorezuar Puniljeño/Prodato Received/Delivery	13.12.2022	2	viti god. year.
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPJESHCK	8025/2022		115.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.903/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.903/2022 të datës 13.10.2022 e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar avokati për ankuesin me adresë:

kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 13.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.903/2022 e datës 13.10.2022 e parashtruar nga ankuesi.
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me numër Nr.1433/2022 i datës 29.09.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe lënda kthehet në rivendosje tek organi i njëjti i cili e ka nxjerr aktin administrativ.
- III. **DETYROHET** Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej 15 ditësh, të ndërmarr veprimet ligjor për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç është përcaktuar në pikën II, të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtij vendim.

ARSYETIM

Ankuesi ne datë 13.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6141/2022 përmes përfaqësuesit të autorizuar avokati nga Prishtina, e regjistruar me numër A.nr.903/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.1433/2022 të datës 29.09.2022 të Zëvendës Drejtores së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Këshilli me datën 11.11.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesë e datës 13.10.2022 e parashtrua në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, me numër protokollit 6141/2022 e regjistruar me numër rendor A.nr.903/2022, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokati nga Prishtina sipas Autorizimit të datës 31.12.2021; Vendimi me numër A.nr.341/2022 i datës 12.09.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimi Nr.1433/2022 i datës 29.09.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Tabela e datës 07.10.2022 e nxjerrë për linjen e transportit të autobusit Mitrovicë-Stantërg-Bajgorë prej 1/3 faqe; Tabela e datës 07.10.2022 e nxjerrë për linjën e transportit të autobusit Dobraj-Poturoc-Prishtinë prej 1/3 faqe; E-maili i datës 05.10.2022 zyrtar lidhur me respektimin e orarit të punës, nga Zyra e Ekzekutiv të SHGJK; fotografi e hartës së Kosovës, destinacioni dhe largësia nga vendbanimi i ankuesit deri tek vendi i punës, e nxjerrë nga Google Map; Përgjigje në ankesë e datës 11.11.2022 nga Zyrtari për zhvillim të rekrutimit /MPB; E-mail i datës 07.11.2022 mbi pranimin e vendimit nr. 1433 të datës 29.09.2022; Diploma Universitetit e datës 28.02.2012 Nr.51 e ankuesit; me titullin Master i shkencave teknike; Diplomë Universitetit të Prishtinës e datës 24.06.1998 Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë; Certifikatë e datës 28.04.2010 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës mbi magjistraturën e shkencave teknike, e noterizuar me datë 27.03.2013 me numër ref.LRP.3338/13; CV-e ankuesit, lidhur me vendbanimin, përgatitjen arsimore/ universitare dhe përvojën e punës; E-mail i datës 09.11.2022 nga Zyrtari për zhvillim të rekrutimit /MPB, drejtuar me kërkesë lidhur me vendbanimin e ankuesit; Emil i datës 09.11.2022 përgjigje nga lidhur me kërkesën e Zyrtarit për zhvillim të rekrutimit /MPB.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në rivendosje, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, është konstatuar se Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, me datë 22.01.2020 ka nxjerre Vendimi me numër Nr.03/117 , sipas të cilit ankuesit i është vazhduar mandat si Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës edhe për tri (3) vite. Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 29.12.2021, ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.31/52, me të cilin ka bërë shfuqizimin e Vendimit Nr.03/117 të datës 22.01.2020 për vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën si Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, me arsyetimin që ky vendim është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në

Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës . Me datën 04.03.2022, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër A.nr.07/2022, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 06.01.2022, si të pabazuar .

Ankuesi me datën 24.03.2022, përmes përfaqësuesit të tij ligjor, ka parashtruar kërkesë tek Zëvendësuesja e Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, lidhur me emërimin e tij në një pozitë të nivelit të mesëm drejtues. Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmes aktit administrativ sqarues me numër Nr.509 të datës 04.04.2022, ka kthyer përgjigjen tek ankuesi në lidhje me kërkesën e tij.

Ankuesi i pakënaqur me aktin administrativ sqarues me numër 509 të datës 04.04.2022, nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datën 06.04.2022, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 1912/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se ky sqarim përmban shkelje ligjore dhe procedurale, dhe se i njëjti kërkon nga Këshilli që ta aprovoj ankesën e tij, ta anuloj sqarimin e DMZP-së të datës 04.04.2022, të sistemohet në një pozitë të nivelit të mesëm drejtues si dhe ti paguaj pagat dhe beneficionet lidhur me pozitën Drejtor i Përgjithshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 12.09.2022 ka nxjerrë Vendim me numer A.nr.341/2022 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e ankuesit, duke e lënë në fuqi Vendimin numër Nr.13/52 të datës 29.12.2021 të Qeveris së Republikës së Kosovës dhe duke obliguar Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme-DMZP-në që ankuesit ti bëjë kompensimin në mënyrë retroaktive të pagave nga dita e shkarkimit deri në momentin e zbatimit të këtij vendimi konform legjislacionit në fuqi si dhe po ashtu ka obliguar Drejtorin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit, duke e sistemuar ankuesin në pozitë të mesme drejtues në shërbimin civil në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Lidhur me zbatimin e Vendimit A.nr.341/2022 të datës 12.09.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.09.2022 Zëvendësuesja Drejtorja e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka nxjerrë Vendimin Nr.1433/2022 me të cilin ankuesin e ka sistemuar në pozitën "*Drejtor i Muzeut Shtetërore të Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça*", në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, me seli në fshatin Stantërg në Komunë të Mitrovicës, në pajtim me nenin 42 paragrafin 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe disponueshmërisë së vendit të lirë të punës në Ministrinë e Ekonomisë dhe përgatitjes profesionale si dhe përvojës së punës së kaluar në shërbimin civil të republikës së Kosovës.

Ndërsa, ankuesi me datë 13.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.1433/2022 të datës 29.09.2022 të Zëvendësues së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me pretendimin ankimor se i njëjti me rastin e sistemimit në pozitë "*Drejtor i Muzeut Shtetërore të Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça*", në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, në Stantërg - Mitrovicë është me tepër se 140 km (vajtje ardhje), nga vendbanimi i tij, gjegjësisht nga fshati Poturoc i Komunës së Lipjanit. Po ashtu ankuesi pretendon që ti bëhet e mundur që ti ofrohet

vendi punës të lira të kategorisë së mesme drejtuese, në një lokacion të përshtatshëm, që të mund të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e punës që i përgjigjet distanca fizike por dhe të përvojës dhe përgatitjes profesionale të tij në pajtim me legjislacionin në fuqi. Sepse pozita ku është sistemuar ankuesi është në fshatin Stantërg në Komunë të Mitrovicës, ndërsa ankuesi jeton me adresë të vendbanimit në fshatin Poturoc në Komunë të Lipjanit, e që deri në vendin e punës vajtje dhe ardhje është mbi 140 km, dhe deri në vendin e punës, ankuesit i bije të udhëton çdo ditë me transport publik, gjegjësisht në relacionin Puturoc-Prishtinë, Prishtinë Mitrovicë dhe Mitrovicë - Stantërg, autobusi i parë që nisët nga fshati Dobraj-Prishtinë në ora 06:30 dhe mbërrin në Prishtinë ora 07:20, ndërsa nga Prishtina me autobusin e dytë që nisët nga ora 07:30 për në Mitrovicë dhe arrin në ora 08:18, dhe relacioni i tretë nga Mitrovica në Stantërg autobusi i parë që shkon në Bajgorë pas orës 8 e 18 nisët në ora 10:00, andaj me këtë rutinë ditore ankuesi do të bije ndesh me nenin 4 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, sepse mund të jetë subjekt i procedurës disiplinore pa fajin e tij, për shkak të nuk arrijë me kohë në vendin e tij të punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka shqyrtuar Vendimin numër Nr.1433/2022 të datës 29.09.2022 të Zëvendësues së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, dhe si rrjedhojë ka gjetur se vendimi për emërimin e ankuesit në pozitë "Drejtor i Muzeut Shtetërore të Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça", në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, në Stantërg - Mitrovicë, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.6, ku përcaktohet se: 1. *Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.3 shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.* Vendimi në fjalë, në arsyetimin e tij përmban vetëm bazën ligjore mbi të cilën është nxjerr vendimi, dhe një përshkrim të gjëndjes faktike se: *Pozita "Drejtor i Muzeut Shtetërore të Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça", në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, në Stantërg - Mitrovicë, të lartpërmendurit i ofrohet në bazë të konfirmimit të pozitës së lirë nga Ministria e Ekonomisë dhe përgatitjes së saj profesionale, përvojës së punës së kaluar në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mirëpo i njëjti vendim nuk përmban faktet vendimtare si: Përgatitjen profesionale të ankuesit dhe kriteret të cilat kërkohen për pozitën përkatëse të emërimit, si dhe përvojën e punës të ankuesit dhe arsyen pse kjo përvojë është adekuate në rastin konkret. Rrjedhimisht, arsyetimi i vendimit nuk përmban përshkrimin rreth përshtatshmërisë së ankuesit për pozitën përkatëse e cila do t'i siguronte palës mundësinë që ta kuptonte aktin administrativ. Po ashtu, vendimi i kontestuar nuk përmban një shpjegim të gjëndjes faktike, nëse në kohën e emërimit të ankuesit ka qenë vetëm kjo pozitë e lirë, apo ka pasur me shume pozita të lira por emërimi është bërë sipas diskrecionit të Zëvendës Drejtores të DMZP-së, dhe nëse është ushtruar diskrecioni, mungon shpjegimi se pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë si në vendim.*

Kolegji vlerëson se të metat e tilla të aktit administrativ e bëjnë të paligjshëm Vendimin Nr.1433/2022 të datës 29.09.2022 të Zëvendësues së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si rezultat i kësaj nuk ka qenë i mundur trajtimi i ligjshmërisë së pretendimeve ankimore dhe vendosjes në mënyrë meritore lidhur me ankesën, kështu që duke u bazuar në neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin

e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që lënda të kthehet në rivendosje të organi i njëjtë, gjegjësisht Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

Zëvendës Drejtorja e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, në procedurë të rivendosjes, duhet t'i marr parasysh pikëpamjet juridike të këtij vendimi dhe t'i eliminoj të metat e konstatuara të aktit administrativ.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.903/2022

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar Avokatit
- Zëvendës Drejtores të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB;
- Drejtorit të Përgjithshëm të SHGJK-së;
- Arkivit të KPMSHCK-së.